



Në kuadër të Programit për zhvillimin Rajonal në Shqipëri për skemën e granteve për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin që ka si objektiva kryesore:

1. Të mbështesë qasjet e integruara që kontribuojnë në qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve duke krijuar sinergji e duke plotësuar ndërhyrjet e përcaktuara në “Programin për Zhvillimin e Integruar dhe të Qëndrueshëm të 100 + Fshatrave të Shqipërisë 2022-2026”
2. Të rrisë potencialin ekonomik në mikro rajone dhe të përmirësojë kapacitetet vendore e rajonale sipas nevojave dhe potencialeve të evidentuara në sektorë të tillë si: kultura, turizmi, kërkimi dhe zhvillimi, mbrojtja e mjedisit dhe edukimi, duke mbështetur nisma të nxitura nga politika zhvillimi dhe krijimi i rrjeteve social-ekonomike;
3. Të mbështesë zhvillimin social-ekonomik në mikro rajone nëpërmjet përmirësimit të aksesit të shërbimeve sociale.

Bashkia Gjirokastrë në cilësinë e aplikuesit lider, **Bashkia Dropull** në cilësinë e bashkë-aplikantit dhe **Instituti i Kërkimeve Urban (URI)** në cilësinë e partnerit të projektit, janë kualifikuar si fituese në këtë thirrje me projektin : **Zhvillimi ekonomik alternativ në zonat me risk të lartë të veprimeve ilegale/informale si mbjellja e kanabisit në Gjirokastrë dhe Dropull**

Vendndodhja(et) e projektit: *Bashkia Gjirokastrë (Lazarat, Asim Zenel); Bashkia Dropull (Sotirë)*

Kohëzgjatja totale e projektit (në muaj): 10 muaj

Shuma e kërkuar: 35,008,511.91 ALL

Financim FZHRSH: 29,999,684 ALL

Bashkëfinancim Bashkia Gjirokastrë: 5,584,827 ALL

Objektivi i përgjithshëm: Projekt-propozimi synon të nxisë një zhvillim të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm social dhe ekonomik, duke inkurajuar potencialin për zhvillim ekonomik dhe uljen e pabarazive ekzistuese.

Projekti ka këta objektiva specifikë:

- i. Të mbështesë procesin e grumbullimit të bimëve medicinale dhe aromatike dhe më tej përpunimin e produkte kozmetike, duke u fokusuar në angazhimin e të rinjve fermerë dhe grave fermere e familjet e tyre, kryesisht atyre që jetojnë me ndihmë ekonomike;

A project of:



Implemented by:





**FONDI SHQIPTAR
I ZHVILLIMIT**



- ii. ii. të rris ndërgjegjësimin e publikut kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, me vëmendje të veçantë fshatrat e prekura nga kultivimi i kanabisit, të rinjtë dhe të rejtat e familjeve që jetojnë me ndihmë ekonomike dhe të rinjtë dhe të rejtat e papuna apo me arsim të ulët.

Grupet kryesore që projekti do të synojë janë:

- i. Një minimum prej 30 fermerësh, me një fokus të veçantë të rinjtë dhe gratë në zonat e sipërpërmendura të njësive administrative, të prekur më parë nga kultivimi i kanabisit;
- ii. Familjet që jetojnë me ndihmë ekonomike nga bashkitë Gjirokastrë dhe Dropull, në të njëjtat njësi administrative por edhe me gjere;
- iii. Grumbullues të bimëve medicinale dhe aromatike në qarkun e Gjirokastrës, apo në rang vendi;
- iv. Bashkia Gjirokastrë, Bashkia Dropull – njësitë e qeverisjes vendore përgjegjëse për territoret respektive, të cilët kanë në fokus zhvillimin e turizmit dhe mbrojtjen e mjedisit në territoret e tyre respektive.

Përfituesit përfundimtarë

- i. Popullsitë e bashkive Gjirokastrë dhe Dropull;
- ii. Bashkitë me stafet e tyre, 3 Njësitë Administrative të përzgjedhura, Zyrat e Punës, Drejtoritë e Shërbimeve Sociale në dy bashkitë;
- iii. Sipërmarrësit e angazhuar në sektorin e bimëve dhe nënprodukte të bimëve medicinale dhe aromatike;
- iv. Biznese të tjera si hotele, bujtina, restorante që përdorin nënproduktet e bimëve medicinale dhe aromatike, të përpunuara nga banoret e zonës;
- v. Turistet vendas e të huaj;
- vi. OSHC-të që operojnë në të 2 bashkitë e përzgjedhura.

A project of:



Implemented by:

